

Tabela e përmbajtjes

A.	RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR.....	0
B.	BILANCI KONTABEL	2
C.	PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	3
D.	PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE	4
E.	PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALET E VETA.....	5
F.	SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE	6-17

Bilanci kontabël
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013
(Të gjitha balancat janë në lekë)

	Shënime	Viti raportues 31.12.2013	Viti paraardhës 31.12.2012	
A	AKTIVET			
I	Aktive Afatshkurtera			
	Aktive monetare	3	1,098,974	4,864,424
	Derivativë dhe aktive të mbajtura për tregtim		-	-
	Aktive të tjera financiare afatshkurtra	4	579,755,628	579,205,643
	Inventari	5	21,948,664	48,527,811
	Aktivët afatshkurtra të mbajtura për shitje		-	-
	Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra		-	-
	Totali i Aktiveve Afatshkurtera(I)		602,803,266	632,597,878
II	Aktive Afatgjata			
	Investimet financiare afatgjata		-	-
	Aktive afatgjata materiale	6	1,136,882,313	1,137,279,949
	Aktivët afatgjata jomateriale		-	-
	Kapital aksionar i papaguar		-	-
	Aktive të tjera afatgjata		-	-
	Totali i Aktiveve Afatgjata(II)		1,136,882,313	1,137,279,949
	TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		1,739,685,579	1,769,877,827
	Llogari jasht bilancit TEC-e		850,581,518	
B	DETYRIMET DHE KAPITALI			
I	Detyrime Afatshkurtera			
	Huamarrjet	7	-	-
	Huatë dhe parapagimet	8	307,766,565	219,954,283
	Grantet dhe të ardhurat e shtyra		-	32,403,552
	Provizionet afatshkurtra		-	1,200,000
	Totali i Detyrimeve Afatshkurtera (I)		307,766,565	253,557,835
II	Detyrime Afatgjata			
	Huatë afatgjata	9	-	-
	Huamarrje të tjera afatgjata		-	-
	Provizionet afatgjata		-	-
	Grantet dhe të ardhurat e shtyra		-	-
	Totali i Detyrimeve Afatgjata (II)		-	-
	Totali i Detyrimeve (I+II)		307,766,565	253,557,835
III	Kapitali			
	Kapitali i rregjistruar (aksionar)	10	1,813,683,000	1,813,683,000
	Primi i aksionit		-	-
	Njësitë ose aksionet e thesarit (negative)		-	-
	Rezerva statutore		9,533,341	9,533,341
	Rezerva ligjore	10	-	-
	Rezerva të tjera	10	181,680	181,680
	Fitimet(humbja) te pashpërndara		(332,417,288)	(192,879,558)
	Fitimi (humbja) e vitit financiar	11	(59,061,719)	(114,198,471)
	Totali i Kapitalit (III)		1,431,919,014	1,516,319,992
	Llogari jasht bilancit TEC-e		850,581,518	
	TOTALI I DETYRIMEVE E KAPITALIT (I,II,III)		1,739,685,579	1,769,877,827

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013
 (Të gjitha balancat janë në lekë)

Përshkrimi i Elementëve	Shënime	Viti raportues 31.12.2013	Viti paraardhës 31.12.2012
1 Shitjet neto			
2 Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit(Pu	.	26,179,492	60,652,062
3 Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dl	.	-	-
4 Materialet dhe mallrat e konsumuara		(8,114,102)	(16,242,460)
5 Kosto e punës			
Pagat e personelit		(36,467,089)	(26,023,307)
Shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetsore		(5,924,448)	(3,210,840)
6 Amortizimet dhe zhvlerësimet			(6,359,985)
7 Shpenzime të tjera		(34,735,572)	(123,013,941)
8 Totali i shpenzimeve (shuma 4 - 7)		(85,241,211)	(174,850,533)
9 Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+/-3-8)		(59,061,719)	(114,198,471)
10 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluara		-	-
11 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet		-	-
12 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare		-	-
12.1 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga		-	-
12.2 Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat 767, 667			
12.3 Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi 769, 669			
12.4 Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668			-
13 Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare		-	-
14 Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)		(59,061,719)	(114,198,471)
15 Shpenzimet e tatimit mbi fitimin 69			
16 Fitimi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)		(59,061,719)	(114,198,471)
17 Elementët e pasqyrave të konsoliduara		-	-

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e rrjedhjes së parasë(cash flow)
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013
(Të gjitha balancat janë në lekë)

Pasqyra e fluksit monetar – Metoda idnirekte	Shenime	Viti raportues 31.12.2013	Viti paraardhës 31.12.2012
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi para tatimit		(59,061,719)	(114,198,471)
Rregullime për:			
Amortizimin		-	6,359,985
Humbje nga këmbimet valutore		-	-
Të ardhura nga investimet(Vlera e AAM-ve te shitura)		439,679	-
Shpenzime për interesa		-	-
Rritje/rënie në tepricën e kërkesave të arkëtueshme nga aktivit		(549,985)	3,533,392
Rritje/rënie në tepricën inventarit		26,579,147	(19,269,719)
Rritje/rënie në tepricën e detyrimeve, për t'u paguar nga aktiviteti		54,208,730	109,385,023
Mjete monetare të përfituara nga aktivitetet		21,615,852	(14,189,790)
Interesi i paguar		-	-
Tatim mbi fitimin i paguar		-	-
Mjete monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		21,615,852	(14,189,790)
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese			
Blerja e shoqërisë së kontrolluar X minus paratë e arkëtuara		-	-
Blerja e aktiveve afatgjata materiale		(42,043)	(422,900)
Të ardhura nga shitja e pajisjeve		-	9,759,235
Interesi i arkëtuar		-	-
Dividendët e arkëtuar		-	-
Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet investuese		(42,043)	9,336,335
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare			
Hyrje nga emetimi i kapitalit aksioner		-	-
Hyrje nga huamarrje afatgjata		-	-
Pagesat e detyrimeve të qirasë financiare		-	-
Dividendët e paguar		(25,339,259)	-
Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet financiare		(25,339,259)	-
Rritja/rënia neto e mjeteve monetare		(3,765,450)	(4,853,455)
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël		4,864,424	9,717,879
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël		1,098,974	4,864,424

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013
 (Të gjitha balancat janë në lekë)

	Kapitali i rregjistruar(aksionar)	Teprica rivlersimi	Rezerva te tjera	Fitimi pashpërndarë	Totali
Pozicioni më 31 Dhjetor 2011	1,813,683,000	9,533,341	181,680	(192,879,558)	1,630,518,463
Efekti ndryshimeve ne politikat kontabë	-	-		-	-
Pozicioni I rregulluar	1,813,683,000	9,533,341	181,680	(192,879,558)	1,630,518,463
Fitimi neto për periudhën kontabël				(114,198,471)	(114,198,471)
Dividentët e paguar					-
Rritje e rezervës së kapitalit	-	-	-		-
Emetimi i kuotave(aksioneve)	-	-			-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2012	1,813,683,000	9,533,341	181,680	(307,078,029)	1,516,319,992
					-
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-		(59,061,719)	(59,061,719)
Ndrysh. fitim/humbje e pashperndare	-	-		(25,339,259)	(25,339,259)
Emetim i kapitalit aksionar	-	-	-	-	-
Rritje e rezervës së kapitalit			-		-
Aksione te thesarit te riblera	-	-	-	-	-
					-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2013	1,813,683,000	9,533,341	181,680	(391,479,007)	1,431,919,014

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i “Petrol ALba” sh.a ne likujdim dhe jane

Hartuar :

Firmosur

Shefi i Finances

Likuidatori

Blerta Uka

Artan Gjokaj

Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013
(Të gjitha balancat janë në lekë).

Informacione te pergjitheshme

Shoqëria anonime "PETROL-ALBA" sh.a, ne likujdim, eshte krijuar me daten 29/04/2008 me urdhrin e Ministrit te Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes Z.Genc Ruli nr. 296 date 29/04/2008 me kapital 1.166.768.000 leke 100% shteteror dhe gjendet e rregjistruar ne rregjistrin tregtar(QKR), indentifikuar me NIPT-in K 81706017 T. Kapitali rregjistruar aktualisht eshte 1.813.683.000 leke dhe zotrohet nga ortakut themelues, MZHETS.

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte : **Magazinimi, tregtimi me shumice dhe pakice i karburanteve dhe nenprodukteve te tyre etj.**

Me urdherin nr.975 date 01.12.2011 te Ministrit te Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes Z.Nasip NACO, shoqeria PETROL ALBA sha kalon ne likujdim.

Shoqëria ka seline e saj ne Tirane dhe 5 filiale ose D.SH.K. ne rrethet: Lac, Elbasan, Pogradec, Gjirokaster, Sarande.Kjo shoqëri ka ne perberje te kapitalit te saj edhe ish Uzinen e Rafinerise se Naftes Cerrik. e cila i eshte shtuar kapitalit te shoqerise PETROL ALBA sha sipas Urdherit nr. 854 date 31.10.2011 te Ministrit te Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes Z.Nasip NACO. Sipas VKM Nr.613 dt. 24.07.2013,Shkreses se METE Nr. 1373/37 , dt. 02.09.2013 kjo uzine i eshe dhene me koncension shoqerise KURUM INTERNATIONAL sh.a.Gjithashtu me urdherin nr.756 date 11.10.2011 te Ministrit te Ekonomise,Tregtise dhe Energjetikes Z.Nasip NAÇO jane kaluar ne administrim te shoqerise PETROL ALBA sha TEC-t Tirane, Korce, Maliq,Cerik, Kucove dhe Vlore ku vlera e AQT-ve te tyre dhe e gjendjes se magazines eshte pasqyruar si llogari jashte bilacit. Organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullohet ne baze te dispozitave te legjislacionit ne fuqi, statutit dhe aktit te themelimit te kesaj shoqerise. Organet drejtuese te shoqerise jane:
Keshilli mbikqyres:

- | | | |
|------------|--------|---------|
| 1. Suzana | Stefa | Kryetar |
| 2. Juliana | Mata | Anetar |
| 3. Dritan | Spahiu | Anetar |

Likujdator i shoqerise: **z. Artan Gjokaj**

Permbledhje e politikave kontabel

Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-te). Ato jane pergatitur mbi bazen e parimit te koston historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit te te drejtave te kostatuara. Paraqitja e tyre eshte bere ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar ("lekë).

Ne mbyllje te periudhes 01janar-31 dhjetor 2013 jane hartuar pasqyrat financiare permbledhese te cilat bazohen mbi te dhenat e kontabilitetit analitik dhe sintetik te mbajtur ne Drejtori I cili mbahet i informatizuar sipas programit Financa 5.

Gjendjet financiare paraqiten ne Lek, e cila eshte monedha kombetare dhe e paraqitjes se pasqyrave financiare te shoqerise

1. Kuadri ligjor:Ligji 9228 date 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"
2. Kuadri kontabel I aplikuar: Standartet Kombetare te Kontabilitetit ne Shqiperi.
3. Baza e pergatitjes se PF :Te drejtat dhe detyrimet e konstatuara.
4. Parimet dhe karakteristikat cilesore te perdorura per hartimin e PF

Njesia ekonomike raportuese ka mbajtur ne llogarite e saj aktivet,pasivet dhe transaksionet ekonomike te veta.

Shoqeria eshte ne likujdim. Keshtu qe per pergatitjen e pasqyrave te saj financiare nuk eshte ndjekur Parimi i Vijimesise.

Kompensim midis nje aktivi dhe pasivi nuk ka, ndersa midis te ardhurave dhe shpenzimeve ka vetem ne rastet ku lejohen nga SKK.

Kuptueshmeria e pasqyrave financiare eshte e realizuar ne masen e plote per te gene te qarta dhe te kuptueshme per perdorues te jashtem qe kane njohuri te pergjithshme te mjaftueshme ne fushen e kontabilitetit.

Materialiteti eshte vlersuar nga ana jone dhe ne baze te tij Pasqyrat financiare jane hartuar vetem per zera materiale.

Besueshmeria per hartimin e pasqyrave financiare eshte e siguruar pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e meposhtme :

Parimin e paraqitjes me besnikeri

Parimin e perparemise se permbajtjes ekonomike mbi formen ligjore

Parimin e paanshmerise pa asnje influencim te qellimshem

Parimin e maturise pa optimizem te tepruar, pa nen e mbivleresim te qellimshem.

Parimin e plotesise duke paraqitur nje pamje te vertete e te drejte te PF

Parimin e qendrushmerise per te mos ndryshuar politikat e metodat Kontabel.

Parimet kontabile më domethënëse që janë përdorur nga shoqëria, janë si më poshtë:

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare përfshijnë mjetet monetare në arkë,banke dhe depozitat me afat. Ekuivalentët e mjeteve monetare janë investime afatshkurtra, shumë likuide dhe të gatshme për t'u konvertuar në shuma të njohura të mjeteve monetare dhe të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

Veprimtari të shfrytëzimit janë aktivitetet bazë të prodhimit të të ardhurave të njësisë ekonomike dhe aktivitetet të tjera të cilat nuk janë aktivitetet investuese ose financuese.

Veprimtari investuese janë blerja, dhe nxjerrja e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentët e mjeteve monetare.

Aktivitetet financuese janë aktivitetet që cojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kontribuar dhe të dhe huamarrjeve afatgjata ose aftashkurtëra nga njesia ekonomike.

Overdraftet bankare konsiderohen si financim,si flukse nga veprimtaria financiare, dhe si rrjedhim përjashtohen nga Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare.

Paraqitja në bilancin kontabël korespondon me Mjetet monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

Aktivitetet financiare

Shoqëria i klasifikon aktivitetet financiare në Llogari/Kërkesa të arkëtueshme nga klientët dhe në Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme. Menaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare. Aktivitetet financiare paraqiten në bilanc me vlerën neto nga zhvlerësimi nëse ka.

Llogari/Kërkesa të arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësisë ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare nga klientët e saj. Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtuar nga klientët ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për tu arkëtuar vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuar me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i njësisë për t'i mbajtur ato deri në maturim.

Një zhvlerësim për rënie vlere të të drejtave për t'u arkëtuar krijohet atëherë kur është evidente që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje që t'i arkëtojë të gjitha shumat ashtu siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për tu arkëtuar. Konsiderohen tregues të rënies së Vlerës së Llogarive të Arkëtueshme: Vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, ndoshta debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar, dhe moskryerja apo vonesat në pagesa. Shoqëria vlerëson çdo vit mundësinë e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme për secilin klient dhe kur një Llogari e Arkëtueshme vlerësohet që nuk mund të arkëtohet, ajo regjistrohet në shpenzimet dhe në Llogarinë e kërkesave të Arkëtueshme. Nëse më pas arkëtohet shuma të cilat janë çregjistruar, atëherë kreditohen shpenzimet e shitjes dhe administrimit për këto shuma.

Kërkesa të tjera të arkëtueshme njihen kur njësi ka një të drejtë për të marrë mjete monetare ose përfitime në të ardhmen si pasojë e një ngjarje të ndodhur, përveç shitjes, dhe kur vlera e përfitimeve matet në mënyrë të besueshme. Kërkesat e tjera të arkëtueshme vlerësohen në hyrje dhe në bilanc me të njëjtën parime si dhe llogaritë e arkëtueshme.

Inventarët

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK-4 "Inventarët", kur shoqëria i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjërish, kur mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme.

Në hyrje inventarët e mallrave dhe materialeve vlerësohen me koston e tyre që përfshin tërësinë e çmimeve të blerjes dhe të shpenzimeve të bëra për të sjelle inventarët në kushte magazinimi, kur këto kosto mund të identifikohen me besueshmëri.

Produktet e gatshme vlerësohen në hyrje me koston e prodhimit të tyre (duke përfshirë shpenzimet indirekte të prodhimit nëse është rasti).

Në bilanc inventarët paraqiten të vlerësuara me vlerën neto, pra më të vogël midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus koston e parashikuara të shitjes.

Aktivet afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale (AAM-të) bazohen në modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me koston minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalin e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Amortizimi për të gjitha grupet, llogaritet dhe njihet me metodën e vlerës së mbetur, me norma të cilat janë të përafërta me jetegjatesinë mesatare të parashikuar të përdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Shoqëria nuk ka llogaritur shpenzime amortizimi për vitin 2013 pasi ajo ndodhet në likuidim.

Detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata

Detyrimet shoqëria i klasifikon në afatshkurtra dhe afatgjata.

Huamarrjet afatshkurtra njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë koston e transaksionit. Huat më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga koston e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas. Huat klasifikohen si detyrime afatshkurtra, me përjashtim të rastit kur shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

Detyrimet afatshkurtra klasifikohen në Detyrime tregtare/Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve dhe të detyrime të tjera. Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tregtare të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas në bilanc paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar.

Detyrimet ndaj shtetit për tatimet dhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore paraqiten me shumën e tyre të llogaritur sipas kërkesave ligjore në fuqi më datën e ndërtimit të pasqyrave financiare.

Huat afatgjata vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuar me koston e amortizuar. Çdo diferencë midis ripagesave (neto nga koston e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria zbaton parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtit ushtrim kontabel. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për tu paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregetar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal.

1. Aktive monetare (likujditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjetet monetare në banke dhe arke, në leke, në datat 31 Dhjetor 2013 dhe 31 Dhjetor 2012 janë si më poshtë:

Emertimi i Llogarise	Monedha	Gjendja ne 31.12.2013		Gjendja ne 31.12.2012	
		Ne leke	Ne valute	Ne leke	Ne valute
Llogari bankare	LEK	865,781	0	4,535,760	-
Arka ne leke	LEK	233,193	0	328,664	-
Shuma		1,098,974	x	4,864,424	x

Gjendjet e llogarive të likujditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare janë të njëjta me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike të monedhave. Teprricat e shprehura në monedhë të huaj, janë përkthyer në leke duke përdorur kursin e këmbimit të fundit të ushtrimit të bankes respektive.

2. Aktive të tjera financiare afatshkurtra

Kerkesat e arketueshme dhe aktive te tjera financiare, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2013 deklarohen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012
Aktive të tjera financiare afatshkurtra		
(i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme	402,303,279	403,838,836
(ii) Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme	114,186,824	111,618,770
(iii) Instrumente të tjera borxhi	63,265,525	63,748,037
(iv) Investime të tjera financiare	0	0
Shuma	579,755,628	579,205,643

Ne "Llogari / Kërkesa të arkëtueshme " jane pasqyruar

- Log. « Kliente »..... 457,320,136 leke
- Llog « Parashikime per zhvleresim »..... -55.016.857 leke
- Totali i klienteve..... 402,303,279 leke

Keta kliente jane te mbartur nga shoqeria Armo qe ne fillim te krijimit te Petrol Alba sh.a sipas DSHK-ve.

Shumat e paraqitura ne "Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme" perfaqesojne:

- "Personel dhe persona"..... 95,699,012 leke
- Detyr. fiskale..... 2,847,014 leke
- Shteti-tatimmbi vleren e shtuar"..... 15,640,798 leke
- Totali 114,186,824 leke

Llog. "Personeli dhe persona" jane te trasheguar nga Armo qe ne fillim te krijimit te Petrol Alba sh.a sipas DSHK-ve.

Ne llogarine instrumenta te tjera borxhi jane pasqyruar

- " Debitore te mbartur "36,492,195 leke
- Debitore te tjere 26,773,330 leke
- Totali 63,265,525 leke

Shuma prej 36,492,194 leke eshte trasheguar nga shoqeria Armo qe ne fillim te krijimit te Petrol Alba sh.a.

Ne lidhje me debitoret e trasheguar nga Armo po punohet per pergatitjen e dokumentacionit per cdo debitor, per te filluar procedurat perkatese per arketimin e tyre.

Drejtimi mendon se nje pjese e konsiderueshme e kerkesave jane pa shprese arketimi per shkak se nje pjese e subjekteve nuk mund te gjenden me, nje pjese e tyre e kane kaluar afatin ligjor te kerkimit te detyrimit ndaj tyre, dhe gjithshu ka mungesa ne dokumentacionin ligjor(fatura origjinale etj), gje qe ben pothuajse te pamundur hapjen e procedurave te rregullta ligjore per kerkimin e detyrimit ndaj ketyre klienteve. Por gjithashtu per nje pjese te klienteve shoqeria ka filluar procedurat ligjore te kerkimit te detyrimit.

3. Inventari

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe fund te ushtrimit paraqiten:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012
Inventari		
(i) Lëndët e para	5,477,565	32,056,712
(ii) Prodhim në proces	-	-
(iii) Produkte të gatshme	-	-
(iv) Mallra për rishitje	16,471,099	16,471,099
(v) Parapagesat për furnizime	-	-
Shuma	21,948,664	48,527,811

Ne llogarine lende te para prej 5,477,565 leke, jane paraqitur vlerat inventareve te imet, ne pronesi te shoqerise ' Petrol Alba' sh.a . Keto shuma jane mbartur ne bilancin e Petrol Alba, nga shoqeria Armo qe ne momentin e krijimit te saj.

Ne lidhje me ndryshimin e vlerave te ketyre inventareve nga 32,056,712 ne vitin 2012 ne 5,477,565 ne fund te vitit 2013, sqarojme se:

Ne fund te vitit 2012 shoqeria ka paraqitur si pasuri te saj ne postin "lende te para" , vlera te materialeve ne magazinat e TEC-eve(Tirane, Cerrik,Kucove,Korce, Maliq dhe Vlore) objekte keto te kaluara ne administrim te shoqerise me urdhrin Nr,756 dt. 11.10.2011 te Ministrit te Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes.Keto vlera "materiale ne magazine" duheshin mbajtur ne llogari jashte bilancit ashtu si eshte vepruar per vlerat e objekteve te tjera te ketyre TEC-eve.

Ne zbatim te shkreses Nr.1561/1 prot, dt.04.02.2014, te MZHETS, ku kerkohet sistemimi i veprimeve ne lidhje me keto zera, eshte bere sistemimi ne bilancin e vitit ushtrimor 2013. Te gjitha vlerat e "materialeve ne magazina" jane trajtuar ne llogarite jashte bilancit duke pasqyruar ne postin "lende te para" vetem inventaret ne pronesi te shoqerise Petrol Alba, sipas percaktimeve te SKK-4 "Inventaret".

Vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e inventarizimeve fizike te kryer per periudhen ushtrimore 2013. Si politike kontabel ne percaktimin e kostos se inventarit eshte perdorur metoda e "mesatares se ponderuar".

Shuma e inventarit te paraqitur ne " mallra per rishitje" perfaqson stokun e mallrave gjendje ne fund te ushtrimit te vleresuar me vleren neto te realizueshme.

Analiza e kesaj llogarie ne 31.12.2013 paraqitet si me poshte.

- Gazoil 129,410 litra x 94 leke/liter.....12,247,704 leke
- Solar 158,625 kg x 26.330 leke/kg..... 4,176,594 leke
- Graso 360 kg x 130 leke/kg.....46,800 leke

Totali i mallrave gjendje 16,471,099 leke

Drejtimi mendon se vlera e paraqitur eshte vlera me e ulet mes kostos se marrjes dhe vleres neto te realizueshme dhe nuk eshte nevoja per zhvleresime te tij.

4. Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale ne pasqyrat financiare paraqitet si vijon:

Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndertesa	Makineri dhe paisje	Aktivitet te tjera afatgjata materiale	Totali
A Kosto e AAM-ve me 01.01.2013	1,041,883,439	94,682,314	44,632,702	4,360,034	1,185,558,489
Shtesat	35,680	-	6,363	-	42,043
Pakesimet	(35,680)	(194,905)	(91,363)	(270,000)	(591,948)
Kosto e AAM-ve 31.12.2013	1,041,883,439	94,487,409	44,547,702	4,090,034	1,185,008,584
B Amortizimi AAM-ve 01.01.2013	-	15,988,501	29,821,239	2,468,800	48,278,540
Amortizimi ushtrimit	-	-	-	-	-
Amortizimi per daljet e AAM-ve	-	(61,220)	(59,549)	(31,500)	(152,269)
Amortizimi i AAM-ve 31.12.2013	-	15,927,281	29,761,690	2,437,300	48,126,271
C Zhvleresimi AAM-ve 01.01.2013	-	-	-	-	-
Shtesat	-	-	-	-	-
Pakesimet	-	-	-	-	-
Zhvleresimi AAM-ve 31.12.2013	-	-	-	-	-
D Vlera neto e AAM-ve 01.01.2013	1,041,883,439	78,693,813	14,811,463	1,891,234	1,137,279,949
Vlera neto e AAM-ve 31.12.2013	1,041,883,439	78,560,128	14,786,012	1,652,734	1,136,882,313

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2013.

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe spjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston(SKK-5).Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

Drejtimi mendon se pergjithesisht per kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te renjes ne vlere te AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime.

Shoqeria nuk ka llogaritur shpenzime amortizimi per vitin ushtrimor per shkak se ka nderprere aktivitetin e sa dhe ndodhet ne likujdim.

5. Detyrime afatshkurtera-Huamarrjet

Shoqeria nuk ka hua te klasifikuara si afatshkurter ne fund te ushtrimit 2013.

6. Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2013 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012
Huatë dhe parapagimet		
(i) Të pagueshme ndaj furnitorëve	107,264,529	88,987,734
(ii) Të pagueshme ndaj punonjësve	33,965,229	23,254,377
(iii) Detyrimet tatimore+sig.shoqerore	40,855,072	28,212,504
(iv) Hua të tjera	91,216,826	79,499,668
(v) Hua ndaj buxhetit	34,464,909	0
Shuma	307,766,565	219,954,283

“Të pagueshme ndaj furnitorëve” pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e mallrave e sherbimeve pa u likujduar ne fund te ushtrimit. Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara realisht.

“Të pagueshme ndaj punonjësve“ perbehet nga detyrimi i papaguar ndaj personelit ne 31.12.2013

“Detyrimet tatimore+sig.shoqerore“ perfaqesojne detyrimin per :

· Tatimin mbi te ardhurat personale.....	10,608,882 leke
· Sigurimet shoqerore e shendetesore.....	29.438,423 leke
· Tatim ne burim	978,805leke
· Parapagim tatim fititim	- 171,038 leke

“Hua te tjera “ perfaqesojne detyrimet ndaj te treteve ;

- Huave ndaj shoqerive te tjera shteterore.....	64,722,575 leke
- Detyrime kreditore te mbartura nga Armo.....	6,376,389 leke
- Detyrime per ceshtje gjyqesore.....	26,450,694 leke
- Detyrime per qera	2,480, 000 leke
- Te drejta ndaj te treteve.....	- 8,812,832 leke

“ Hua ndaj buxhetit “ne shumen 34,464,909 perfaqesojne vleren e materialeve ne magazine te TEC-ve kaluar ne administrim te shoqerise me urdherin nr.756 date 11.10.2011 te Ministrit te Ekonomise,Tregetise dhe Energjetikes. Gjate vitit 2012 dhe 2013 shoqeria ka realizuar shitje me ankande publike te ketyre materialeve.Fondet e siguruara nga keto shitje jane perdorur nga shoqeria per mbulimin e shpenzimeve operative te shoqerise pa marre me pare miratimin paraprak per perdorim nga institucionet perkatese. Kjo situatë eshte sistemuar ne bilancin e vitit 2013 dhe keto fonde jane paraqitur si detyrime te shoqerise ndaj buxhetit.

7. Detyrime Afatgjata-Huate afatgjata

Shoqeria nuk ka detyrime afatgjata ne fund te ushtrimit 2013

8. Kapitalet e veta

Kapitali i regjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, eshte i njejte me ate te percaktuar ne statutin e shoqerise dhe vendimet e depozituara ne QKR. Me 31.12.2013 .Ai eshte 1.813.683.000 leke, i ndare ne 1.813.683 aksione me vlere nominale 1.000 leke /aksion. Me vendim e ortakut te vetm MZHETS humbja e vitit 2012 eshte mbartur ne fitimet e pashpermdara.

9. Fitimi (humbja) e vitit financiar

▪ **Te ardhurat**

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur Dhjetor 2012	31
Te ardhurat			
Te ardhurat nga shitja e produkteve	0		0
Te ardhurat nga shitja	19,042,173	20,625,826	
Te ardhurat te tjera(Shitja AAM)	380,240	831,300	
Te ardhurat nga grantet/provizionet	4,234,957	37,611,728	
Te ardhurat te tjera	2,522,122	1,583,208	
Shuma	26,179,492	60,652,062	

“Te ardhura nga shitja e mallrave dhe sherbimeve” pasqyrojne:

Te ardhurat nga shitja e materialeve ne magazine te TEC-eve, te trajtuara me lart ne seksionin e inventareve.

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe sherbimeve jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, te zhveshura nga TVSH-ja.

“Te ardhura te tjera” pasqyrojne:

Te ardhur te realizuara nga shitja e asetëve te shoqërisë, dhe rivlersime mardhenie me klientet.

Paraqitja ne pasqyrat financiare e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere sipas natyres se tyre.

▪ **Shpenzimet e veprimtarise kryesore**

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane regjistruar me shumet e paguara ose te pagueshme. Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktësisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar.. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2013 jane treguar ne pasqyren perkatese.

Zeri “Shpenzime te tjera” pasqyruar ne piken 7 te Pasqyres se te Ardhurave dhe Shpenzimeve analizohen si vijon.

	Viti raportues 31.12.2013	Viti paraardhës 31.12.2012
Energji, uje	41,940	15,553
Qera	2,575,000	2,125,000
Telefoni, internet	32,508	208,434
Sherbime ruajtje objekti	25,353,783	56,258,628
Shpenzime eksperte	2,072,000	1,200,000
Sherbime permbarimi/ Penalite vendim.gjyqsore 2012	1,846,889	24,063,483
Tatime,taksa dhe derdhje te ngjashme	169,492	10,350,477
Te tjera personeli	1,424,320	
Vlera kontabel AAM te shitura	439,679	804,000
Aplikime dhe komision banke	69,866	21,249
Zhvlersime , xjerrje jasht perdorimit		25,937,653
Te tjera sherbime	710,095	2,029,464
	34,735,572	123,013,941

▪ **Te ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Jane paraqitur si diference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve. Shumat e tyre nuk jane materiale.

▪ **Kosto e punes**

Ketu perfshihen pagat e personelit dhe shpenzimet per sigurime shoqerore te pasqyruar ne Pasqyren e te Ardhurave dhe Shpenzime, pika 5.

10. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shoqeria nuk ka pasqyruar shpenzime per tatim fitimin per vitet 2012 dhe 2013 pasi ka rezultuar me humbje.

	Viti raportues 31.12.2013	Viti paraardhës 31.12.2012
I FITIMI NETO PARA TATIMIT	(59,061,719)	(114,198,471)
II SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)	169,492	62,225,658
1 Amortizime tej normave fiskale	-	-
2 Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor	-	-
3 Gjoha,penalitete,demshperblime	-	-
4 Provizione qe nuk njihen	-	-
5 Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta	-	-
6 Te tjera	-	-
III PJESA E HUMBJES SE MBARTUR(-)	(332,417,288)	(192,879,558)
IV FITIMI (HUMBJA) TATIMORE(I+II-III)	(391,309,515)	(244,852,371)
V Shpenzimi i tatim fitimit-10%		
VI FITIMI NETO I USHTRIMIT(I-V)	(59,061,719)	(114,198,471)

Ne lidhje me llogarine “Fitim/humbja e pashperndare” sqarojme se:

Ne fund te vitit 2012 shoqeria ka paraqitur si pasuri te saj ne postin “lende te para” , vlera te materialeve ne magazinat e TEC-eve(Tirane, Cerrik,Kucove,Korce, Maliq dhe Vlore) objekte keto te kaluara ne administrim te shoqerise me urdhrin Nr,756 dt. 11.10.2011 te Ministrit te Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes, duke i trajtuar si grante te dhena nga shteti. Gjate vitit 2012 shoqeria ka realizur shitjen e nje pjese te ketyre materialeve me procedura te njejta qe shoqeria perdorte per aktivet e saj, dhe ka paraqitur ne pasqyrat e saj financiare dhe te ardhura te realizuara si rimarrje nga grantet te cilat kane dhene efektin e tyre ne paraqitjen e rezultatit financiar te vitit 2012.

Sipas bilancit te vitit 2012 “Humbja e mbartur” ne 31.12.2013 paraqitet ne shume 307,078,029 leke.

Me miratimin e pasqyrave financiar te vitit 2012, me shkresen Nr.1561/1 prot, dt.04.02.2014, te MZHETS kerkohet sistemimi i veprimeve ne lidhje me keto zera, ku vlera e materialeve te shitura nga objektet ne administrim te njihen si detyrime kreditore ndaj shtetit dhe jo si grante.

Ne zbatim te kesaj shkrese eshte bere sistemimi perkates ne pasqyrat e vitit 2013, ku vlera e inventareve te shitur ka kaluar ne llog. detyrime ndaj shtetit, dhe pjesa e te ardhurave te paraqitura si rimarrje nga grantet gjate vitit 2012, eshte sistemuar ne llogarine “fitim/humbje te mbartura”, ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit.

Si rezultat llogaria “fitim/humbje te mbartura” eshte debituar per shumen prej 25,381,302 leke.

Gjithashtu kjo llogari eshte kredituar per shumen prej 42,043 leke si rezultat I rivlersimit dhe shitjes se se objektit, Pika Peqin, ne perputhje me rregullat e percaktuara ne SKK.

11. Transaksione te paleve te lidhura

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksioni dhe marredhenie te mundeshme, jo thjesht per sa I takon formes ligjore te tyre , informojme se ne 31 dhjetor 2013 dhe 31 Dhjetor 2012 nuk ka transaksione me palet e lidhura.

12. Llogari jashte bilancit

Ne llogarine jashte bilancit , paraqitet vlera e aktiveve materiale te objekteveTEC-e, te cilat aktualisht jane ne administrim te shoqerise

13. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare.

14. Shifrat krahasuese

Shifrat krahasuese te deklaruar ne pasqyrat financiare 2012 jane te njejta me ato te prezantuara ne vitin actual 2013.

SHEFI I FINANCES

BLERTA UKA

LIKUIDATORI

ARTAN GJOKAJ